

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 16.07.2021 DATUM: 16.07.2021 DATE RECEIVED/SUBMITTED:			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
05	48	1243	3



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR/FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE/HEALTH INSURANCE FOND	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
FSSH	1509
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data Datum Date
- 3 -	16.07.21

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond

DATE/A:	16/07/2021
PËR/ZA/TO:	Zj. Hykmete BAJRAMI Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike Kuvendi i Republikës së Kosovës Z. Besnik OSMANI Zyra Kombëtare e Auditimit
CC:	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Plaqiqi, Drejtor i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për vitin e përfunduar 31.12.2020

Te nderuar

Duke ju referuar raportit të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për vitin e përfunduar 31.12.2020, ne brenda afatit kohor kemi përgatitur planin e veprimit për zbatimin e plotë rekomandimeve.

Për me tepër ne kemi caktuar personin përgjegjës për përcjelljen e planit të veprimit deri në zbatimin e plotë të tij.

Me respekt!

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për vitin e përfunduar 31.12.2020

Raporti i Kapitujve	Institucionet përgjegjëse - Departamenti	Aktivitetet	Afati i Implementimit
Çështja A1 - Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor			
Rekomandimi A1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë qe faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Zyrtari Kryesor Administrativ Zyrtari Kryesor Financiar Menaxheri i Kontratës Certifikuesi	Rekomandim i zbatuar. Vonesat që kanë ndodhur si rrjedhojë e pandemisë dhe paqartësive në vendimin e KRPP-së për shtyrje të afatit të liferimit, janë adresuar para pranimit të këtij rekomandimi.	E zbatuar Mars 2021
Çështja C1 - Mos arsyetimi i mjeteve për trajtimet mjekësore të subvencionuara			
Rekomandimi 2 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të krijojnë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese për rastet jo urgjente janë duke i respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara. Nëse kjo është e përcaktueshme atëherë të shqyrtohet mundësia e ndryshimit të UA 03/2017.	Zyrtari Kryesor Administrativ Departamenti për Shërbime Shëndetësore Divizioni për TMJIShP	UA 03/2017 nuk siguron mekanizma për zbatimin e këtij rekomandimi, si dhe nuk siguron konkurrencë të plotë. Si rrjedhojë në vitin 2019 është hartuar një draft udhëzim i cili është i bazuar në konkurrencë dhe transparencë të plotë dhe është dërguar në Ministri për aprovim (nënshkrim). Megjithatë ky draft udhëzim ende nuk është nënshkruar dhe tani është prapë në proces të draftimit të ri. Megjithatë Drejtori i Fondit për të siguruar se çdo pagesë e bërë është në përputhje me shërbimin e ofruar, ka themeluar Komisionin për Barazime me Institucione Shëndetësore Private, komision i themeluar në fillim të vitit 2019 i cili vazhdon barazimet financiare për çdo transaksion të realizuar.	Adresimi i mangësive të identifikuar në UA aktual TM3-2021. Ndërsa procesi i barazimeve do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm deri në barazimin e pagesës së fundit.

		<p>Pas rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike që barazimet të behën në periudha gjashtëmujore, Drejtori i Fondit ka rishikuar vendimin duke rritur stafin edhe për dy (2) punonjës.</p> <p>Komisioni me prioritet do të barazoj periudhat gjashtë (6) mujore si dhe njëkohësisht do të vazhdojnë barazimet edhe për vitet paraprake, përfshirë edhe kohën kur programi i TMJISHP ishte në menaxhim të Ministrisë së Shëndetësisë.</p>	
Çështja C2 - Mos aplikimi i sistemit e-pasuria			
Rekomandimi C2			
Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë se është vënë në funksion sistemi e-pasuria dhe se janë bërë gjitha regjistrimet e nevojshme në sistem.	<p>Zyrtari Kryesor Administrativ</p> <p>Zyrtari Kryesor Financiar</p> <p>Zyrtari i Pasurisë</p>	Ashtu si është konstatuar edhe në raportin e ZKA, Fondi në vazhdimësi ka adresuar kërkesat për mundësinë e përdorimit të sistemit E-pasuria, tek institucioni përkatës (MAP). Ne do të vazhdojmë kërkesat tona deri në zbatimin e rekomandimit, përkatësisht vënien në funksion të sistemit E-pasuria.	TM3-TM4 2021